

KUMTESA DHE SHËNIME

INJAC ZAMPUTI

PJETËR MAZRREKU DHE FJALORTHI I TIJ I VJETIT 1633

Për jetën e Pjetër Mazrrekut, autor i fjalorthit të vjetit 1633, dijmë shumë pak për të mujtë me bamë një biografi të plotë. Familja e Mazrrekajve që e njohun në shekullin e XVII-të në Prizrend ku lindi dhe u rrit Pjetri. Ky ndoq karrierën kishtare dhe, si na tregon Farlati, që vikar apostolik i dioçezeve të Serbisë. Me këtë funksion ai më 1617 botoi konstitucionet sinodale. Prandaj themi se Pjetër Mazrreku zu vendin që për shtatëmbëdhjetë vjetë kishte mbajtur nëpër Kosovë Pjetër Budi deri sa, më 1616, ishte nisë për Itali.

Na e njohim Pjetër Mazrrekun edhe me funksionin e vizitatorit apostolik, po nëpër dioçezet e Serbisë (Kosovë) dhe të vendeve të tjera të Ballkanit, me anën e relacionit të tij të vjetit 1623/1624.

Ky relacion i hollësishëm, që ai dërgoi në Romë, asht një dëshmi për veprimtarinë e këtij njeriu, që i shikonte me sy realist nevojët e vendeve dhe, për qeverisjen e mirë kishtare, ngulte kambë se duheshin prelatë vendas. Kështu Roma, me dekretin e 16 shtatorit 1624 e caktoi të bahej arqipeshkev i Tivarit dhe primat i Serbisë, në vendin e Marin Bicit.

Pjetër Mazrreku, me këtë funksion të ri, iu përvesh menjëherë punës. Tetë muj pasi kishte qenë emnue arqipeshkev, e gjejmë tue bamë vizitat e veta dhe, nga Trepsha, me letrën e 15 majit 1625, ankohet në Romë sepse i kërkojnë punë por nuk i japin mjetet e nevojshme. Aso kohe, titullarët e Tivarit e kishin të pamundun të qëndronin në këtë qytet, prandaj edhe Pjetër Mazrreku selinë e pati në Shkup ose në Janjevë. Bile ai mendoi dhe propozoi të ndërtohej një seli e përherëshme në këto anë, ku ta kishin qendrën prelatët e ardhshëm. Në vazhdim të veprimtarisë së vet, bani edhe relacionin e vjetit 1633 ku gjendet fjalorthi i tij i njohun. Vdiq më 1635.

* * *

Relacioni i vjetit 1623/1624 gjendet i botuem në vëllimin XXXIX të *Starine*-ve. Ne si shqiptarë, përveç të dhanave të tjera që interesojnë bashkëvendësit tanë të Kosovës dhe të vendeve të tjera ku gjendeshin aso kohe elementë të kombësisë sonë, na tërheq vemendjen sidomos hovi dashunor me të cilin Autori, Pjetër Mazrreku i ynë, flet për Shqipninë e për shqiptarët, megjithëse tërthorazi dhe për digresion sepse "nuk i që dhanë urdhën të vizitonte Shqipninë". Në këtë digresion na paraqitet një pamje e gjendjes në Shqipni drejtue kryesisht për të parashtrur nevojën e madhe që kishte këtu për shkolla.

Fjalorthi prej 32 fjalësh, së bashku me dy copëza të relacionit të vjetit 1633, e njihnim në botimin që ka bamë albanologu i njohun Mario Roques¹).

Këto vjetët e fundit, kemi pasë fatin të shtijmë në dorë të gjithë relacionin (ose të themi ma mirë: relacionet e bashkueme) të vjetit 1633 të këtij prelati shqiptar. Aty kemi edhe ato "Pak fjalë mbi kombën shqiptar" (*Breue discorso sopra la natione Albanese*) ku përfshihet edhe fjalorthi i thanun²).

Këto pak fjalë, apo kjo "ligjëratë e shkurtër" mbi Shqipërinë dhe shqiptarët asht një tjetër tribunë — sikurse digresioni i vjetit 1623/1624 por me masa ma të mëdha, me qenë se tash Autori flet i mveshun me autoritetin e një arqipeshkvi-primat të cilit duhet t'i eci fjala—tribunë ku Pjetër Mazrreku e ngre zanin për të mprojtë kombësinë shqiptare, që aso kohe po sulmohej shumë, sidomos nga prelatët e huej të dërguem në vendin tonë. Në këtë "ligjëratë të shkurtë", ky njeri kërkon edhe njëherë e me të madhe hapjen e shkollave për shqiptarët, sikurse ka qenë vepruc për të gjithë popullsitë e Ballkanit dhe të viseve të tjera. Dhe, në këtë drejtim, Autori vihet të provojë se shqiptarët e meritojnë një interesim të tillë, për dobinë e tyre dhe të të gjithë Evropës, sepse, sikurse shqiptarët "do t'ishin shumë të vlefshëm në rast të ndonjë ndërmarrje lufte" (*potriano essere di grandissimo giouamento in occasione di qualche impresa di guerra*), ashtu edhe, nëse do të braktisen dhe lihen pa shkolla e pa kujdes "do t'ishin për dam shumë të madh të krishtenimit" (*sariano di grandissimo danno alla christianità*).

Për ta pështetë kërkesën e vet që të hapen shkolla për shqiptarët, Pjetër Mazrreku ban një paraqitje të shkurtë, por me të dhana shumë të randësishme, të gjendjes në Shqipëri.

Tue folë për qëndresën e pamposhtun të dukagjinave dhe për përpjekjet e turqve që t'i nënshtrajnë, relatori na jep disa të dhana me interes historik dhe gjuhësor në lidhje me qytetin e Kukësit. Kur flet për Drinin e Zi dhe të Bardhin, thotë se këta bashkohën "në vaun e Kukit, i quejtun kështu nga familja me të njejtin emën" (*al guado di Cucchi così detto per la fameglia dell'istesso nome*). Në këtë mënyrë ai na jep origjinën historike t'emnit të këtij vendi.

Vrejmë se, në relacionin e Pjetër Mazrrekut, emni jepet në trajtën e gjinisë mashkullore: *Kuki*, por ma tutje, ku përmend një pjesëtar të kësaj familje thotë: "Ahmet Beg Kuka" (*Ahmet Beg Cuca*), gja kjo që nuk na len dyshim se qoftë *Kuki* qoftë *Kuka* janë trajta të të njejtij llagap.

Pjesa tjetër e relacionit që flet për numrin e banorëve në malet e Dukagjinit dhe për nevojën e tyre dhe të të gjithë Shqipërisë, duket qartë e ndërtueme për të tërheqë vemendjen e Romës që shqiptarët të konsiderohen si një popull jo vetëm i fortë, luftarak dhe i pamposhtun, por edhe i etshëm për kulturë e dije dhe mbrenda këtij konteksti, ma në fund, Autori sjell edhe ato 32 fjalë të fjalorthit të vet.

Ndjekës dhe shok i burrave të shquem shqiptarë të periudhës së lulëzimit ma të madh të përpjekjeve të shqiptarëve për liri në kalim prej shekullit të XVI-të në të XVII-tin, Pjetër Mazrreku mbron me të gjitha argumentet kombësinë dhe vjetërsinë e shqiptarëve në bashkësinë ballkanike. Dhe këtë e ban sepse duhej kërkuje e gjetë shërimi për gjendjen e keqe në të

1) *Le Dictionnaire albanais de 1635* édité etc. par Mario Roques" Paris, Libr. Orientaliste P. Geuthner, 1932.

2) *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*; përgatitur nga Injac Zamputi, vëllimi I, Tiranë, 1963, Dokum. Nr 37, fq. 429-457.

cilën gjendej populli shqiptar nën pushtimin turk, dhe ky shërim nuk asht tjetër veçse të hapen shkollat edhe për shqiptarët sikurse ka qenë vep-rue për ballkanasit e tjerë.

Për këtë arsëye ai kapet pastaj edhe te gjuha shqipe.

Para se ta nisë rrjeshtimin e atyne 32 fjalëve të fjalorthit të njohun; thotë se shqiptarët "gjuhën e kanë të ndryshme prej gjuhëve të tjera me shumë fjalë italiane e greke" (*hanno lingua diuersa dalle altre lingue con molti uocaboli Italiani, et Greci*).

Në këtë pikë, para se të shtrojmë pyejtjen përse Pjetër Mazrreku i sollti ato 32 fjalë t'afrueme me po aq fjalë italishte, dhe para se të nxjerrim përfundimin për t'i dhanë përgjegje kësaj pyetje, mendojmë se asht me vend të japim, sado shkurtas, disa shënime rreth kontakteve që kishte aso kohe gjuha shqipe "e ndryshme prej gjuhëve të tjera" në bashkësinë ballkanike të këtyne anëve veri-lindore.

Pjetër Mazrreku tregohet se asht njohës shumë i mirë i gjuhës serbishte aq sa, në një vend të relacionit, tue folë për serbët, hyn edhe në një gjykim gjuhësor: "quhen serbë, janë rritit grek, dhe me gjuhë sllave, që ata e quejnë serbski jezik, d.m.th. gjuhë serbe, ma e pastra e ma e kthiellta që mund të ketë ndër sllavët" (*sono chiamati Serbi di rito Greco, e di lingua schiauaona, che loro chiamano Serbski Jesik cioe lingua Serbina la più polita e tersa, che ci sia fra schiauaoni*), dhe vazhdon tue e krahasue serbishten, në grupin e gjuhëve sllave, me toskançen në dialektet italike, dhe flet për ndryshimet që ka midis serbishtes dhe bullgarishtes etj. Ai kishte pra një pregtitje të tillë sa të gjykonte edhe mbi gjuhët lelsav.

Në lidhje me katolikët e disa vendeve të Kosovës, ai pohon "megjithëse ata të Serbisë flasin sllavisht, prap, me që rrjedhin prej Shqipnie, sot quhen shqiptarë" (*se bene quelli di Seruia parlano in schiauaone, nondimeno perehe discendono da Albania, sono chiamati hoggi di Albanesi*).

Se cilat ishin këto vende, ku shqiptarët katolikë kishin marrë zakonin të flisnin sllavisht, na ndihmon t'i dijmë relacioni i vjetëve 1641/1642 i pasardhësit të Pjetër Mazrrekut në selinë e Tivarit, Gjergj Bardhi. Ky na pohon: "Ata të Serbisë së poshtme, d.m.th. Prizrendi me krabinë të Hasit, Gjakova, famullia e Shën Mërisë së Shegjeçit, flasin gjuhën epirotike, d.m.th. shqipe, dhe duen që të kenë meshtrarë dhe famullitarë me gjuhën e tyne shqipe" (*queli della Seruia inferiore coie (sic) presren e' prouinzia di hasci Jachoua parochia di S. Maria Segieci questi tutti parlano in lingua epirota Coie (sic) Albanese, et uogliono che siano sacerdoti, et curati della propria lingua Albanese*) dhe: "Serbia e epër flet e gjitha në gjuhën ilirike dhe i duen priftnit që ta dijnë po atë gjuhë" (*La Seruia Superiore tutti parlano in lingua Iliricha, et uogliono li preti che sapiano la istesa lingua*).

Nga çitimi i maparshëm i Pjetër Mazrrekut, na rezulton se katolikët e disa qendrave të dioceseve të Serbisë (Kosovës) janë shqiptarë pavarësisht se flasin gjuhën serbishte t'adoptueme në kushtet e bashkëjetesës dhe të punës së përbashkët ndër miniera etj. me punëtorinë sllave.

Për këtë arsëye, priftnit e prelatët që punuen nëpër këto dioçeze, në shumicën e tyne kanë qenë shqiptarë, sepse shqiptarë qenë besimtarët, por duhej të dinin edhe serbishten bashkë me shqipen, sepse ashtu e lypte realiteti i gjendjes. Për të mos shkue gjatë në këtë çashtje, që do të kërkonte një trajtesë më vchte, na po sjellim këtu një shënim që, në fund të këtyne relacioneve të Pjetër Mazrrekut, kanë vendosë në Romë ata që aso kohe e morën në studim. Pasi ky shënim flet për besimtarët e Prizrendit, Trepçes, Janjevës, Novobrdos, Letnicës, Shkupit e Kratovos, thotë:

"Këta njerëz janë me gjuhë shqipe dhe sllave, dhe arqipeshkvi, me që i din të dyja këto gjuhë, ka qenë shumë me vend" (*Sono queste anime di lingua Albanese, e schiauona, e l'Arcivescouo hauendo ambè queste lingue è stato molto a proposito*).

Prelati shqiptar, i cili me aq forcë e ngre në këto relacione çashtjen shqiptare, aty ku asht fjala për sulmet që u bahen kombësisë dhe aftësi të shqiptarëve nga rrymat anmiqësore, përballë këtij realiteti që kishte ardhë tue marrë jetë në kushte të bashkëjetesës paqësore në punë të përbashkët, nuk sheh ndoshta ndonjë rrezik që duhej luftue në këtë mes. Luftën, ai dhe shokët e tij, e bajnë të hapun e t'ashpër kur i hapun dhe i ashpër asht sulmi. Bashkëjetesa me popullsinë kufitare nuk i ka topitë kurr shqiptarët, por gjithmonë kanë kërkuë të gjendeshin në kushte të barabarta me të tjerët. Prandaj, edhe në rasën konkrete, Pjetër Mazrreku lyp hapjen e shkollave të përbashkëta, kështu që "shqiptarët do të mësonin sllavishten dhe ata të Serbisë shqipen" (*li Albanesi impareriano schiauone, e quelli di Seruia in Albanese*). Të kihet parasysh se fjala asht gjithmonë për besimtarët katolikë të diçezeve të Serbisë (Kosovës), ku, fundi i fundit, kishte edhe popullatën zotnuese shqiptare-myslimane.

Pa një luftë të hapun, por me të drejta të barabarta, prelati shikon në këto shkolla të përbashkëta edhe rrugën paqësore nëpër të cilën shqiptarët katolikë t'atyne vendeve duhej të ruenin gjuhën amtare dhe mundësitë ata që e kishin lanë pas dore, ta fitonin prap. Por kjo nuk do të thonte mot himin e realitetit të bashkëjetesës, dhe prandaj edhe shqiptarët duhej të mësonin serbishten.

Vendosja e çashtjeve në një nivel barasie, asht një nga meritat e shqiptarëve t'atyne kohëve që kurdo kanë kërkuë një bashkëpunim të sigurtë me popullsi të tjera kufitare. Dhe, po ashtu sikurse në fushën politike u kërkuë bashkëpunimi, kur burrat e kuvendeve shqiptarë u shtruen në bisedim krah për krah me burrat e të gjitha krahinave ballkanike për të gjetë mënyrën e një lufte të përbashkët çlirimtare, ashtu nuk kishte pse mos të kërkohej, bashkëpunimi edhe në fushën e kulturës dhe t'arësimit. Në se pastaj dështuen të tilla përpjekje, faji duhet kërkuë te rrymat anmiqësore që e cenuen dhe e damtuen këtë bashkëpunim.

Pas gjithë këtyne që thamë, na shtrohet pyetja: Përse Pjetër Mazrreku, kur e paraqet gjuhën shqipe "të ndryshme nga të tjerat", ndalet e pohon vetëm për huazimet (si i kuptonte ai) nga italishtja dhe nga greqishtja? A mos duhet të pohojmë se aso kohe, në gjuhën shqipe, nuk kishte fjalë të huajtura nga gjuha sllave, apo vetë shkruesi nuk dinte t'i dallonte? Jo.

Pas mendimit tonë, kësaj i duhet dhanë shpjegimi me dy synime që kishte Autori: të provonte aftësitë e popullit shqiptar për qytetnrim dhe njëkohësisht të faktonte se me huazime të tilla (shkenca gjuhësore endë s'kishte arritë të bajë dallimet midis huazimeve dhe prejardhjeve të përbashkëta nga një trung i vetëm i gjuhëve indoevropiane), me këto huazime pra që kapen në lashtësinë greke dhe italiane (bijë e parë e latinishtes), vetë gjuha shqipe asht provë edhe për autoktonitetin shqiptar. Ato 32 fjalë që, si thotë ai, janë "disa" nga të tilla huazime, tregojnë ndoshta (në mendjen e autorit) vetëm për synimin, e parë të tij. Por ai, me thianien e maparëshme se në shqipen ka huazime edhe të gjuhës greke, tregohet i gatshëm, po ta lypte nevoja, të formojë edhe lista të tjera të tilla.

Gjuha italishte numërohej si një gjuhë e kulturue me që kishte depërtue në sferat intelektuale dhe artistike të principatave e të mbretnive të ndryshme kur letrarë dhe artistë të tjerë italianë, së bashku me fitoret e Rilindjes (Rinashimentos), çuen nëpër Evropë edhe tingujt e gjuhës.

Kur më 1610, paraardhësi i Pjetër Mazrrekut në selinë e Tivarit, Marin Bici, erdhi në Budue dhe deshi të shkonte në Tivar, i shkroi qytetarisë tivarase një letër që t'u lexohej besimtarëve, dhe u kujtue keq të përdorte në të gjuhën sllave. Kjo punë, thotë ai vetë, shkaktoi keqardhje dhe letra "qe pritë me sy shumë të keq në Tivar, sepse unë ia paskëshem shkruie n'atë gjuhë një komuniteti tue i trajtue si injorantë që nuk e kuptuekan gjuhën italishte" (*molto mal veduta in Antivari, perchè io l'havessi mandata in quella lingua ad una comunità trattandoli da ignoranti, che non intendessero la lingua Italiana*). Pavarësisht se kjo keqardhje justifikohet vetëm në këtë aspekt, mund të mendohet me të drejtë se aty fshihet edhe një aspekt tjetër. Me të vërtetë aso kohe, shumica e banorëve të Tivarit ishin shqiptarë dhe flisnin shqip. Por prap, na nuk mund të mos i japim randësinë e duhur çashtjes së njohjes ose jo të gjuhës italishte për të provue kulturën ose jo të njerëzve të kohës.

Kështu pra, na mendojmë se fjalorthi prej 32 fjalësh i Pjetër Mazrrekut don të plotësojë synimin e parë të tij: se shqiptarët janë njerëz që vihen lehtësisht dhe me etje në kontakt me kulturën, dhe se prandaj janë të aftë të ndjekin shkollat ndër Kolegjet e Italisë. Ky, pas mendimit tonë, ishte synimi imediat, sepse me të vërtetë kërkesa e tij konkrete ishte të hapeshin kolegje për shqiptarët.

Tue e vendosë që në krye çashtjen e huazimeve të shqipes nga gjuha italishte dhe nga gjuha greke, na mendojmë se ai synonte edhe te një kontribut tjetër për zgjidhjen e problemit të madh që ishte vu në rendin e ditës, sikurse pamë, nga sulmet që i drejtoheshin popullit shqiptar prej rrymave anmike që donin ta paraqisnin jo-ballkanas, këtë popull t'ardhun në kohë të vona etj.

Tue pohue se gjuha shqipe ka fjalë të huajtura nga italishtja dhe nga greqishtja, provohet nga ana tjetër se shqiptarët, kanë pasë, që në kohë të lashta, marrëdhënie me popujt që flisnin gjuhët italiane dhe greke, të njohuna për lashtësinë e tyre. Ky asht një argument i shëndoshë edhe sot, kur të provoheshë lashtësia e huazimeve (s'po themi analogjive) në gjuhën shqipe. Për këtë arsye, na mendojmë se Pjetër Mazrreku as që i përmend huazimet sllave, me që këto duhej t'i shikonte si të vona, pavarësisht se ai nuk ishte në gjendje të dinte për lashtësinë e huazimeve të fjalëve italiane dhe greke. Hë-për-hë atij i duket se, për kërkesën e shkollave, mjafton vetëm shëmbulli që jep me ato 32 fjalë: "Do të themi disa nga fjalët italishte" (*Diro delle parole italiane alcune*), dhe nënkupton se do të kishte të tjera të tilla, edhe të fjalëve greke të cilat as nuk i çek.

Pasi e kryen pra paraqitjen e këtyne 32 fjalëve, ngul kambë edhe një herë për nevojën që shqiptarëve t'u hapet një kolegj sepse "ky komb ka nevojë të madhe për kolegj aq sa ka nevojë për vetë shëllblimin" (*quest anatione ha tanto bisogno di Collegio, quant'ha bisogno dell' istessa salute*) dhe përfundon: "në qoftë se nuk do të merren masa për një rrënim kaq të madh [ishte fjala se tashma pushtuesi turk po ushtronte të gjithë tiraninë e vet mbi shqiptarët — I.Z.] me shkolla e kolegje, mbaroi ky komb, humbja dhe dënimi i të cilit do të shkaktohet nga zelli i pakët e nga dhimbëshunia e paktë e shekujve të tashëm" (*se non si rimedierà a tanta stragge con scuole, e Collegij, è spedita questa Natione, la cui perdita, e dannatione sarà attribuita al poco zelo et alla poca carità dei presenti Secoli*).

Ja prandaj, me pak fjalë, suaza në të cilën u hartue fjalorthi i Pjetër Mazrrekut.

* * *

Por Pjetër Mazrreku, gjatë këtij relacioni të vjetit 1633 mbi Shqipninë

dhe në të tjerat që janë bashkue me të, ka rastin të shkruiej edhe ndonjë fjalë tjetër shqipe dhe, në ndonjë vend, ban edhe përpjekje për etimologji dhe për shpjegim. Na e pamë rastin e Kukësit që na thotë e na provon se vjen nga emni i familjes feudale të Kukejve.

Fjalën *troftë* që gjendet në fund të fjalorthit, e përmend edhe ma parë, në fillim të relacionit mbi Shqipninë, dhe çashtjen e etimologjisë së saj e shtron disi ma gjatë. Tue folë për lumejt e Dukagjinit, thotë se në ta zihen peshq "që edhe në shqipen tue ndryshue një *t* në *f* quhen *trofta*" (*ch'etiam in Albanese, con mutar un, t, in f, trofte sono chiamate*).

Në një vend tjetër, kur na jep emërtimin e dytë të vendit të Hasit pranë Prizrendit, thotë se "asht territori i quejtun Shulla që, po ta themi latinisht, don me thanë: vende të thata ose thatësina" (*è il territorio chiamato Sculaa, che uoöl dir, per dirla in latino loca aprica siue apricationes*). Kjo, sikurse shihet, nuk asht ma një çashtje etimologjice, por shpjegimi i kuptimit të fjalës nëpër latinishten.

Në lidhje me leximin që i kemi ba fjalorthit në fotokopjen e nxjerrun nga dorëshkrimi i origjinalit, kemi disa shënime.

Kur Mario Roques botoi më 1932 fjalorthin e Pjetër Mazrrekut, e nxori nga fleta 255 v. e vëllimit 263 të fondit të njohun SRCG t'Arkivit të Propaganda Fide-s. Fotokopjet e relacionit që kemi në dorë tregojnë se ndërkohë numratimi i fletëve të këtij vëllimi ka pësue ndopak ndryshim. Kështu "Breue discorso sopra la natione Albanese" etj., që M. Roques vendos në fletët 253-257, na rezulton, tue vrejtë numrat e shlyem, se efektivisht n'ato fletë ka qenë përfshimë, por sot, me numratimin e ri, asht i vendosun në fletët 271-275 t'atij vëllimi. Na e shofim të qartë numrin 255 në *recto* të fletës n'anë tjetër të së cilës gjendet fjalorthi. Këtë numër pa edhe M. Roques. Por ky numër asht i shlyem dhe i zevendësuem me numrin e ri 273. Fjalorthi pra sot gjendet jo ma në fletën 255 v., por në fletën 273 v.

Gjithashtu shënojmë se botuesi i parë i këtij fjalorthi, padyshim për nevojë qartësie, e ka botue në fq. 51 të librit të vet në trajtë shtylle, kurse n'origjinalin e dorëshkruem fjalët vijnë njena pas tjetrës në vazhdim të radhëve në këtë mënyrë: Il pane chiamato, *bucche*, à bucella; Il cauallo, *Caale*; Maschio, *Maschule*; femina, *femene*; pollo, *pulle*; Canto, *Canghe*; Cielo, *Chiel*; Gente, *gind*; Popolo, *popule*; Lago, *Lechee*; Gamba, *cambe*; Pelago, *pelagh*; Cartha, *carthe*; Similitudine, *Scembeleture*; Miracolo, *mrecule*; Polpa, *pulpe*; Spada, *scpatte*; Scudo, *schu* & *t*; Arco, *Ark*; Saetta, *sceghiet-te*; Grano, *grune*; Miglio, *mel*; Lepre, *Lepure*; Capriolo, *Capruel*; Faccia, *faghie*; segno *sceng*; Neo, *n* & *e*; Frassino, *frascene*; Cerro, *chiar*; Gregge, *grigh*; pesce, *pesch*; trotta, *trofte*, e molti altri. Fletën 273 v. ku gjendet ky fjalorth po e japim edhe në faksimile.

Sikurse shihet, veç renditjes që ndryshon nga ajo dhanë prej albanologut në fjalë, leximi ynë paraqet edhe ndonjë ndryshim tjetër, të vogël. Në radhë të parë na jemi përpjekë të ruejmë shkrojat e mëdha e të voglat, ashtu si i ka dorëshkrimi, kurse botuesi i vjetit 1932, pas artikullit II të fjalës së dytë, i vazhdon të gjitha fjalët me shkronja të vogla fillestare.

Shënojmë se Pjetër Mazrreku ka një shkrim-dore shumë të vështirë për t'u lexue. Megjithatë kemi bamë përpjekje për të qenë sa ma besnikë. Kështu, në sa M. Roques lexon *pelaghi*, na lexuem *pelagh* sepse, me gjithë një pikë që duket aty, nuk ia shohim askund trupin shkrojes *i*. Gjithnjë Roques lexon *sceghette* kurse na lexuem *sceghiette* sepse e hetojmë aty shkrojen *i*. Dora e Pjetër Mazrrekut ka shkruie fjalën italishte *sepada* dhe kështu e ka lexue M. Roques, por ne na duket se vetë dora e shkruesit e ka shlye aty shkrojen *e*.

fjalë: *shëmbëltyrë*, nuk e kërkon domosdo tingullin e *y*-së dhe, në veshin e autorit duhet të ketë qenë me tingullin fillestar të *u*-së. Ndoshta e njejtja *gja* me fjalën e sotme literaturë-literatyrë etj.

Në fjalën *peshk* ai shkruen: *pesck*) del i qartë përdorimi i bashkëtingëllores *k* kështu si e shkruejm na sot, megjithëqë në fjalë të përdor edhe *c* ose *ch*. Kështu p.sh. shkruen *Pucha* por ma poshtë shkruen tjera zakonisht dy heresh *Puka* dhe *Puuka*, po kështu me shkrojen.

k. *S' Deçiani. fud* Vrejmë se Frang Bardhi, në relacionin e qershorit 1637 mbi Pukën, 18 herë e shkruen këtë fjalë me *ch*.

Pjetër Mazrreku e përdor shkrojen *k* edhe te fjala *Kthella* dhe, ajo që na kënaq ta shikojmë të shkrueme nga vetë dora e shkruesit, në këtë fjalë del i shkruem edhe tingulli i bashkëtingëllores *th* me atë shenjin e veçantë që në shtypin shqiptar shkoj tue u përdorë, me stilizime të ndryshme ndoshta të *ks* greke, që prej Buzukut deri te shkrimet e Shkodrës të shek. XIX-XX. Në mos qoftë ma e herëshme dora e shënimeve anësore në librin e Buzukut, na mendojmë se ky asht rasti i parë që ndeshemi në këtë

shkroje në shkrimin e dorës.

gji. Kthella, se

Sikurse Budi, ashtu edhe Pjetër Mazrreku, në ndonjë vend ndër fjalët shqipe e ndien kuantitetin e zanoreve, prandaj shkruen *Sculaa* (me dy *a*) dhe *Puuka* (me dy *u*). Për fjalën e fundit vrejmë se Frang Bardhi të 18 herët e shkruen edhe ai me dy *u*: *Puucha*.

Dhe së fundi, një veçanti tjetër për historikun e alfabetit tonë. Pjetër Mazrreku shkruen fjalën *Deçani* kështu: *Deçiani* pikërisht me shkrojen e

sotme *ç*.

ç, e Puntka lan

Ta ketë marrë këtë shenj,

qoftë edhe nga veneciancja por tue i dhanë vlerën e tingullit shqip dhe t'i ketë ikë në këtë rast influencës së shkrojes analoge sllave, mendojmë se hyn në të gjithë përpjekjen e Autorit dhe të shokëve të tij për t'i dhanë shkrimit të shqipes një fizionomi të veçantë shqiptare.

Të gjitha rastet e pame tregojnë, nga ana tjetër, përpjekjen e vazhdueshme të shkrimtarëve tanë për t'i dhanë shqipes alfabetin e saj me shkrojat latine, dhe, po ashtu si për shkrojen *ç*, nuk asht gudi që në të ardhmen që ndeshemi edhe në raste të tjera për të përcaktue atëninë e disa shkrojavetë sot, kushedi nëpër cilën rrugë të vazhdimësisë së traditës së shkrimit të shqipes, bajnë pjesë n'alfabetin tonë.

3) Dhe jo *scegn sil* se gabimisht na ka dalë në shtyp te vëlimi i parë i *Relacioneve* (vepër e thanun) fq. 448.